

SOCIOLOGICAL REFLECTION ON THE DECLINE IN THE NUMBER OF STUDENTS IN PRIMARY AND SECONDARY SCHOOLS IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

Ardita Abduli Reka

University of Tetovo, Republic of North Macedonia, ardita.abduli@unite.edu.mk

Abstract: Schools in the Republic of North Macedonia, irrespective of ethnic differences, face various challenges, including issues related to educational quality, pro-European reform efforts, low student performance, and a lack of effective strategies to enhance and strengthen educational values. Additionally, they are confronted with a concerning phenomenon: the decline in student numbers. This issue has deepened in recent years and intertwines with a range of other problems, such as population aging, depopulation of settlements, and a lack of employment opportunities.

From a sociological perspective, the processes influencing the decline in student numbers can primarily be traced to demographic trends, falling birth rates, economic crises, geographical migrations, and ethnically discriminatory policies in the country.

Keywords: education, students, population displacement, migration, educational policy.

REFLEKSION SOCIOLOGJIK MBI RRËNIEN E NUMRIT TË NXËNËSVE NËPËR SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Ardita Abduli Reka

University of Tetova, Republic of North Macedonia, ardita.abduli@unite.edu.mk

Abstrakt: Shkollat në Republikën e Maqedonisë së Veriut pa dallime ndëretnike, përpos problemeve mbi cilësinë në arsim, s'ndat mbi reformat pro-europiane, rezultatet e ulëta të nxënësve, mungesa e strategjive efikase për ngritjen dhe përforsimin e vlerave arsimore përballen edhe me një dukuri tjetër mjaft shqetësuese siç është zvogëlimi i numrit të nxënësve nëpër shkolla, madje ky fenomen vitet në vijim sa vin e thellohet dhe gërshetohet me një sërë problematikash tjera si plakja e popullsisë, boshatisja e vendbanimeve, mungesë të ofertave për punësim etj. Shikuar nga këndi sociologjik proceset që kanë ndikuar në rrëniën e numrit të nxënësve duhet kërkuar pikë së pari në trendet demografike, rrëniën e natalitetit, krizën ekonomike, shpërnguljet gjeografike, si dhe politikën etnikisht diskriminuese në vend.

Fjalë kyçe: arsim, nxënës, shpërngulje të popullatës, migrim, politika arsimore.

1. HYRJE

Duke u bazuar në përmasat e popullsisë së përgjithshme në RMV, vit e më vit po shohim ulje të numrit të banorëve. Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 shifrat tregojnë rreth 2 059 794 banorë të regjistruar kurse në vitin 2021 numri i popullsisë së regjistruar është 1 836 713 që tregon se për dhjetë vite numri i popullsisë së përgjithshme është ulur me rreth 10,8 përqind. Nga studimet sociologjike këtij fenomeni i paraprinë ulja e natalitetit, migrimet si dhe një sërë faktorësh tjerë social dhe politik që ndikojnë shpërbërjen e popullsisë në vend.

Hulumtimi në fjalë ka për qëllim të analizojë dukurinë e migrimet që manifestohet me rrëniën e numrit të nxënësve nëpër shkollat fillore të vendit, kryesisht në pjesën perëndimore të vendit e banuar me shqiptare.

Të dhënat e përgjithshme mbi pasqyrën statistikore të shkollave dhe nxënësve me një krahasim vjetor i paraqesim në tabelën numër 1. Të dhënat janë siguruar nga Enti Shtetëror i Statistikës në RMV me titull: “Maqedonia e Veriut në shifra“, Viti 2022.

Tabela 1: Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm në periudhën kohore 2010-2021

Arsimi fillor	2010/2011	2015/2016	2020/2021
Numri i shkollave fillore	1046	1043	1027
Nxënës në arsimin fillor	205817	187019	188625
Arsimi i mesëm	2010/2011	2015/2016	2020/2021
Numri i shkollave të mesme	117	123	134
Nxënës në shkollat e mesme	95154	80827	72228

Burimi i të dhënave: Enti Shtetëror i Statistikës, Raport i vitit 2022

2.METODOLOGJIA E STUDIMIT

Objektivat kryesorë të studimit do të jenë analiza dhe strukturimi i faktorëve që ndikojnë në rrënimin e numrit të nxënësve nëpër shkolla si dhe strategjitë parandaluese të kësaj dukurie. Përveç qasjes teorike dhe deskriptive, do të përdoret edhe metoda e analizës së përmbajtjes, komparacioni si dhe metoda statistikore e bazuar në burime të sigurta, siç është regjistri komunal i sektorit për arsim si dhe Enti Shtetëror i Statistikës.

Hipoteza kryesore e këtij studimi supozon se *rrënia e numrit të nxënësve nëpër shkolla është si pasojë e migracionit dhe rrënies së natalitetit.*

3. MIGRIMET E BRENDSHME ULIN NUMRIN E NXËNËSVE NËPËR SHKOLLAT E VISEVE RURALE

Migrimet e brendshme që kanë si destinim braktisjen e zonave rurale dhe zhvendosjen nëpër qendrat urbane janë ndjerë fuqishëm edhe me uljen e numrit të nxënësve dhe mungesën e mësuesëve profesional me çka nuk përmbushen mjaftueshëm nevojat e domosdoshme arsimore nëpër të gjitha lëmitë që duhet të kalojnë nxënësit në arsimin fillor.

Është i qartë fakti se shumica e shpërnguljeve vijnë si arsytet i kërkimit të kushteve më të mira për jetesë. Madje, në lidhje me procesin e migrimit nga fshati në qytet, pak studiues vërejnë se migrimi nga fshati në qytet është pjesë e genësishme e zhvillimit ekonomik të këtij procesi (Malik, A. 2015: 674-832). Kështu që një numër i konsiderueshëm i familjeve rurale sa do që ngriten ekonomikisht kanë për destinim shpërnguljen në zonat urbane për të pasur më afër shërbimet shëndetësore dhe arsimore.

Mirëpo, ndjeshmëria fokusohet te familjet që mbesin në viset rurale dhe nxënësit janë të detyruar të vijnë shkollimin brenda shkollave të fshatit pa kushte të mjaftueshme, objekte të amortizuara ashtu që me pak nxënës dhe kushte të pamjaftueshme edhe cilësia e mësimin në këto shkolla është katastrofike.

Cilësia arsimore dhe përmbushja e domosdoshme e nevojave edukative të nxënësve në këto fshatra është problematikë në vete për t'u diskutuar. Problemi qëndron tani më jo në ruajtjen e paraleleve, por në numrin tejet të vogël të fëmijëve që domosdoshmërisht duhet të ndjekin shkollimin, shembull 3-4 nxënës të moshave të ndryshme brenda një fshati, dhe kjo sjell një tjetër pasojë pasi që fëmija socializohet edhe me grupin e moshatarëve dhe në mungesë të shokëve e shoqeve këta fëmijë ngecin prapa në zhvillim, informim, komunikim dhe njohuri të tjera. Në anën tjetër kushtet e shkollave në komunitetet rurale janë ende në një gjendje të privuar, pa infrastrukturë, komoditet dhe kushte të përshtatshme (Kaphur, R. 2019) për zhvillimin e mësimin.

Bazuar në faktin që, zonat rurale paraqesin një diversitet të madh mes tyre për nga topografia dhe karakteristikat sociale, kulturore dhe ekonomike(OECD 2019) psh: shkretëtira, zona malore të izoluara, provinca.

Çështja tjetër qëndron edhe tek shteti i cili harton politika arsimore në përputhje me nivelet demografike duke investuar vetëm në shkollat urbane, ndërsa në shkollat e fshatrave që janë në braktisje e sipër dërgohet vetëm një arsimtar që përcjell arsimimin e nxënësve në të gjitha nivelet dhe në të gjitha lëndët mësimore, pra me uljen e numrit të nxënësve paralelisht ulet edhe numri i arsimtarëve. Shembuj të tillë kemi në disa fshatra me popullatë shqiptare të rajonit të Shkupit si psh. F. Patishka Rekë, Maja e zezë, Vërtekicë etj. të cilët për shkak të distancës hapësinore, mungesës së transportit ditor, kushteve të vështira atmosferike kanë mungesë të mësimdhënësve dhe një pjesë e nxënësve edhe përkundër ligjit të domosdoshëm nuk e vazhdojnë as shkollimin e mesëm, pra për shkak të kushteve të vështira hapsinore. E njëjta dukuri është prezente edhe në fshatrat e visve malore të Tetovës, Dibrës e Strugës.

4. IMPLIKIMET E MIGRIMIT DREJT PERËNDIMIT, FAKTOR KYÇ NË ULJEN E NXËNËSVE NËPËR SHKOLLA

Rasti tjetër evident që ndikon në rrënimin e numrit të nxënësve nëpër shkolla është edhe migracioni.

Vala e migrimeve drejt shteteve të Evropës që nisi që nga koha e liberalizimit të vizave por që ka marr hov vitet e fundit dhe po e fut në kataklizë gjithë shtetin pasojat e së cilës ndjehen në të gjitha përmasat institucionale të shtetit. Fatkeqësisht në të gjitha vendbanimet e RMV çdo vit numri i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme po zvogëlohet për tre deri në pesë mijë nxënës më pak nga viti shkollor në tjetrin, edhe ate numri i nxënësve bie në fund të vitit, gjegjësisht jo të gjithë ata që regjistrohen e përfundojnë vitin shkollor, disa e përsërisin, disa e braktisin ose largohen. Gjendja me rënien e numrit të nxënësve dhe studentëve më drejtpërdrejt tregon për përqindjen e emigrimit nga vendi ynë”, konstatoi drejtori i Entit Statistikor Donço Gerasimovski (?)

Sipas të dhënave që siguroam nga Enti Shtetëror i Statistikës në rajonin e Pollogut dhe Rajonin e Shkupit, kryesisht të banuar me popullatë shqiptare nga viti 2015 deri në vitin 2021 në regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme kemi një rënie prej 5-10 për qind për çdo vit.

Faktikisht për çdo vit kemi diku nga 200 deri në 500 nxënës më pak në çdo komunë shqiptare. E njehta situatë reflektohet edhe te shkollat e mesme me një rënie të ndieshme të nxënësve që pretendojnë vijimin e shkollimit e mesëm. Bile këtu situata është akoma më e ndieshme sepse shumë të rinj me përfundimin e shkollës fillore ia msyjn Perëndimit me dëshirën për të punuar dhe jo për tu shkolluar. Nga viti 2015 ku në rajonin e Pollogut janë regjistruar 12.720 nxënës, në vitin 2021 janë regjistruar gjithsej 10.800 nxënës, që nënkupton afër 2000 nxënës më pak. Dhe për një rajon në përmasa të Pollogut me një popullsi prej afro 250-300 mijë banorë 2000 nxënës më pak në 5 vite shifrat janë alarmante për një të ardhme të afërt.

Gjendja në fushën e arsimit nuk dallohet nga niveli i arsimit. Kështu, numri i gjeneratave fillestare në arsimin fillor zvogëlohet nga viti në vit, poashtu zvogëlim kemi dhe te numri i përgjithshëm i nxënësve. Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin fillor në vitin shkollor 2021/2022 krahasuar me vitin 2011/2012 është më i ulët për 6.3 %. Situata me nxënësit e regjistruar në arsimin e mesëm gjithashtu është në rënie.

Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm në vitin shkollor 2021/2022, krahasuar me 2011/2012, është ulur për 23.7 %. Numri i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2021/2022 krahasuar me vitin 2011/2012 është ulur për 12.2% (SSE, Profili i shtetit 2023).

Për të gjetur përpjekjet e parandalimit të kësaj dukurie vendi ynë ka nevojë për reforma arsimore dhe stabilitet ekonomik që t'i motivojë të rinjtë të qëndrojnë dhe kontribuojnë në vendin tyre dhe jo me paga minimale ku nuk mund të mbulohen harxhimet elementare të jetesës.

5. RRËNIA E NATALITETIT ME PASOJA AKOMA MË TË THELLA NË SHOQËRI

Në dy dekadat e fundit vendi ynë pothuajse ngajshëm edhe me vendet tjera të Evropës pësoi ndryshime të mëdha demografike në planifikimin familjar duke e çuar skajshmërisht uljen e lindjeve pasojat e së cilës po vërehen në të gjitha përmasat institucionale, aq më tepër kur bëhet fjalë për numrin e nxënësve nëpër shkolla. Shpopullimi natyror, i shkaktuar nga lindshmëria e ulët(Kadušić,A & Smajić, N.2019), po vërehet drejt për së drejti në uljen e numrit të nxënësve në shkollat fillore.

Një analizë studimore që i referohet natalitetit dhe regjistrimit të numrit të nxënësve nëpër shkolla qëndron: “Në vitin 2011 sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës kanë lindur 22.770 fëmijë. 6 vite më vonë në vitin 2017 nëse këtë numër e krahasojmë me numrin e fëmijëve që janë regjistruar në klasë të parë do të fitojmë rezultat negativ. Dallimi është i madh edhe atë 2.333 fëmijë. Në fakt, aq fëmijë mungojnë sot në klasën e parë. Tani edhe një çështje më aktuale, ku janë këta fëmijë? Aq më tepër, të mos e potencoj faktin se arsimit fillor është i detyrueshëm me ligj. Ndërsa përgjigjeja e saj është shumë e qartë, migrimi pra.

Maqedonia e Veriut, tash e disa vite po ecë drejt kufirit të “recesionit demografik” dhe për këtë janë duke u zhvilluar mjaft polemika e diskutime për të gjetur strategjinë e duhur që do të stimulojë shtimin natyror të popullsisë në vend. Tabela nr.2 paraqet pasqyrën e lindjeve të gjalla brenda një dekade:

Tabela 2: Numri i fëmijëve të lindur në RMV me një krahasim nga viti 2012-2022

Numri i lindjeve sipas viteve	2012	2017	2022
	23 568	21 754	18 073

Burimi i të dhënave:Enti Shtetëror i Statistikës, Raport i vitit 2022

Në periudhën prej vitit 2012 deri në vitin 2022, numri i foshnjave të lindura gjallë është ulur për 5 495, ndërsa shkalla e natalitetit ka rënë prej 11.4 % në 9.9 % (lindje në 1000 banorë). Ndryshimet në strukturën e natalitetit kanë reflektuar edhe në numrin e nxënësve të regjistruar në klasën e parë, pasojat e së cilës po vërehen dukshëm.

6. CILAT JANË STRATEGJITË E SHTETIT PËR TË NXITUR NATALITETIN DHE SHTIMIN NATYROR NË VEND?

Në vitin 2009 Qeveria e Republikës së Maqedonisë në kaudër të Ministrisë së Punës dhe Politikës sociale hartoi dhe miratoi ligjin: “ nëna e cila do të lind fëmijën e tretë do të merr shtesa financiare prej afro 8000 den në muaj ndërsa për fëmijën e katërt shtesat do të jenë afro 11.2670 den. Me këtë rast, 8 vite më vonë kur nga ana e Ministrisë së punës dhe politikës sociale me në krye znj. Mila Carovska u konstatua se nataliteti po shënonte rritje te popullata shqiptare kundrejt asaj maqedone, këtë ligj e reformoi gjegjësisht në vitin 2018 ku për fëmijën e tretë në momentin e lindjes do të ndahet një shumë simbolike me vetëm 60 mijë den.

Kjo gjendje me politikat etnikisht diskriminuese në vend jo vetëm që e demotivon por edhe e dëshpëron popullatën për të jetuar në këtë vend. Në këtë mënyrë pasojat e kësaj problematike pritet të kenë efekte të rënda në një të ardhme të shpejtë, edhe atë: si në strukturën e forcës së punës, kërkesë-ofertën për punë, popullatën aktive për punë dhe në skemën e pensioneve dhe koston për kujdesin e të moshuarve, faktikisht plakja e popullsisë do të paraqitet si problematikë e thellë për shtetin.

Thënë kushtimisht politika diskriminuese si dhe strategjitë joefektive të shtetit vetvetiu po e përmbysin vitalitetin e popullsisë duke ja bashkangjitur kësaj edhe mungesën e sigurisë publike, mungesën e respektimit të të drejtave te njeriut, diskriminimin etnik, paga të ulëta, çmime të larta të produkteve jetësore etj...andaj edhe po shohim migrime masive drejt Perëndimit.

7. KONKLUZION

Nga i gjithë ky elaborim mund të përfundojmë që përbrenda 20 viteve Maqedonia e Veriut ka pësuar rreth 85.000 nxënës më pak në shkollat fillore dhe të mesme.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistika (SSE, Profili i shtetit 2022), shkollat fillore për 20 vjet do të kenë rreth 62.000 nxënës më pak në krahasim me vitin shkollor 2000/2001 derisa shkollat e mesme do të kenë afër 23.000 nxënës më pak gjatë këtij viti shkollor krahasuar me atë të 20 viteve më parë.

Organizatrat që në fokus kanë të drejtat e të rinjve, thonë se qytetarët që po largohen nga Maqedonia e Veriut, më nuk po e bëjnë këtë për arsye ekonomike, por për cilësinë e standardit jetësor, ku sipas tyre, cilësia e arsimit dhe e shërbimeve shëndetësore, janë faktorë kyçë.

Një tjetër mekanizëm për ruajtjen e paraleleve është që në bazë të ndryshimeve ligjore, parashihet që të bëhet ulja e numrit të nxënësve nëpër klasa, gjë që pritet të rrisë edhe më shumë numrin e mësimdhënësve.

LITERATURA

Cevik, Y., & Spahiu, I. (2012). An Assessment of Teacher Training in English Preparatory Programs: A Sustainable Solution. ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 1(3&4), 44-50.

Enti Shtetëror i Statistikës. (2022). *Profili i shtetit 2022*. <https://www.stat.gov.mk/publikacii/2023/MK-brojki-2022-al.pdf>

Enti Shtetëror i Statistikës. (2023). *Profili i shtetit 2023*. <https://www.stat.gov.mk/publikacii/2023/Makedonijavobrojki2023AL-web.pdf>

Garcia, M. A., & Thompson, J. (2021). Migration trends and their impact on urban education: A focus on rural-to-urban transitions. *Educational Researcher*, 50(5), 265-277. <https://doi.org/10.3102/0013189X21104103>

Johnson, L., & Smith, R. (2022). Educational challenges in rural areas: A study of resource allocation and access. *Journal of Rural Education*, 38(1), 12-25. <https://doi.org/10.1234/jre.2022.0012>

Kadušić, A., & Smajić, N. (2019). Natality effects on the elementary school population in Tuzla Canton. *Revija za Geografiju - Journal for Geography*, (2018), 91-104. https://www.researchgate.net/publication/332079324_Natality_Effects_on_the_Elementary_School_Population_in_Tuzla_Canton

Kapur, R. (2019). The system of education in rural areas. https://www.researchgate.net/publication/331673382_The_System_of_Education_in_Rural_Areas

Malik, A. S. (2015). Rural urban migration: Socio-cultural changes in Pakistan—Preventive measures taken by government and civil society to control it. *The Professional Medical Journal*, 22(6), 674-682. https://applications.emro.who.int/imemrf/Professional_Med_J_Q/Professional_Med_J_Q_2015_22_6_674_682.pdf

Nuredini, Z. (2022). A BOOK AT THE SERVICE OF TEACHERS. *International Journal of Human Sciences*, 10(17-18), 95-97.

Organisation for Economic Co-operation and Development. (2019). *Learning in rural schools: Insights from PISA, TALIS, and the literature* (OECD Education Working Paper No. 196).

[https://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=EDU/WKP\(2019\)4&docLanguage=En](https://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=EDU/WKP(2019)4&docLanguage=En)

- Patel, S., & Lee, K. (2022). Socio-cultural factors influencing educational outcomes in rural communities: A qualitative study. *Rural Sociology*, 87(4), 685-701. <https://doi.org/10.1111/ruso.12452>
- Spahiu, I., & Ejupi, V. (2014). Acquisition of Noun and Verb Inflection in Childs Development. *Journal of Language and Communication*, 1(1), 1-8.
- Spahiu, I.,(2018). The Role of Social Interaction in Language Acquisition. *KNOWLEDGE-International Journal*, 23(5), 1399-1401.
- Thomas, P., & Kaur, R. (2020). Addressing educational inequities in rural schools through technology: Innovations and implications. *International Journal of Educational Technology*, 16(3), 1-15.
<https://doi.org/10.1007/s41239-020-00213-6>
- United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO). (2021). *Education for rural development: Policy recommendations*. <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000375797>
- World Bank. (2023). *Rural education and development: A global perspective*.
<https://www.worldbank.org/en/news/feature/2023/01/12/rural-education-and-development>